



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:158942

Datë: 02.07.2020

Numri i dokumentit: 01002508

PKR.nr.102/2020

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti i Krimeve të Rënda, trupi gjykues i përbërë nga gjyqtaret: Isuf Makolli – kryetar, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Kimete Mehmeti, në çështjen penale kundër të akuzuarit Gj.D., për shkak të veprës penale: Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës PP/II.nr.5174/2017 të datës 21.09.2018 të Prokurorisë Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda, pas shqyrtimit fillestar, të hapur për publikun, të mbajtur më datë 29.06.2020, në të cilin të pranishëm ishin: prokurori i shtetit Besa Limani, i akuzuari Gj.D., të njëjtën ditë, me datë 29.06.2020, morri dhe shpalli publikisht këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari: **Gj.D.**, nga i ati B. dhe e ëma V., e gjinisë P., i lindur me ..., në fshatin R., Komuna e Klinës ku edhe jeton, me numër personal të LNJ ..., ka të kryer Fakultetin e historisë, i pa punë, i gjendje se dobët ekonomike, shkollën fillore, i pa martuar, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse

Me datë 11.08.2017, rreth orës 21:55, në mënyrë të paautorizuar dhe në kundërshtim me ligjin, në rrugën “M.” në Prishtinë, gjatë patrullimit nga Policia e Kosovës i pandehuri Gj.D. ka mbajtur armë pa autorizim në atë mënyrë që të njëjtit i është gjetur dhe i është konfiskuar një armë pistoletë “SIG” Zvicrane me nr A1051020 dhe një karikator me 9 fishek, për të cilat i pandehuri nuk ka poseduar leja valide nga organi kompetent,-

-më këtë ka kryer veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së

Andaj gjykata në bazë të neneve: 7, 17, 21, 41, 42, 49, 50, 51, 52 e 374 par.1, të KPRK-së, si dhe neneve 248 e 365 të KPPRK-së të akuzuarit i **SHQIPTON**

DËNIM ME BURGIM ME KUSHT,

Në kohëzgjatje prej **tetë (8) muaj burgim**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet, nëse i akuzuari, brenda afatit prej një(1) viti nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale.

Nga i akuzuari konfiskohet, pistoleta “SIG” Zvicerane me nr serik A1051020 dhe një karikator me 9 fishek, si mjet i kryerjes se veprës penale.

Obligohet i akuzuari të paguaj shpenzimet e procedurës penale aq sa do të bëhen sipas llogarisë së gjykatës, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej **30€ (tridhjetë) euro**, brenda afatit prej 15 dite, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore-Departamenti i Krimeve të Rënda në Prishtinë, me aktakuzën PP/II.nr.5174/2017, të dt.21.09.2018, e ka akuzuar të pandehurin Gj.D., se ka kryer veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së.

Gjykata, ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me dt. 29.06.2020, në të cilin ishin të papranishëm prokurori i shtetit Besa Limani dhe i akuzuari Gj.D.

Në seancën e shqyrtimit fillestar pas leximit të aktakuzës nga prokurori i shtetit i akuzuari ka deklaruar: se e ka kuptuar aktakuzën dhe ka pranuar fajësinë për veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së, shpreh keqardhje dhe pendim për veprimet e tija, i njëjti deklaroi se është i sëmur rendë nga veshakët dhe duhet që ti nënshtrohet operimit, lut gjykatën që me rastin e shqiptimit të dënimit ti shqiptoj një dënim sa më të butë.

Gjykata, pas pranimit të fajësisë nga i akuzuari ka marrë edhe mendimin e prokurorit të shteti lidhur me pranimin e fajësisë nga i akuzuar, e i cili është pajtuar me pranimin e fajësisë, nga i pandehuri dhe se ky pranim u bë vullnetshëm konform dispozitave të KPPRK dhe duke qenë i vetëdijshëm dhe i njoftuar për pasojat dhe benefitet e pranimit të fajësisë.

Gjykata, pas pranimit të fajësisë nga i akuzuar, mendimet të prokurorit të shtetit, gjykata bazuar në nenin 248 të KPPRK-së, me aktvendim ka pranuar fajësinë nga i akuzuari, pasi që gjykata është bindur se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimi është bërë me vullnet dhe vetëdije të plotë pa presion apo ndikim, pranimi është i mbështetur edhe në provat materiale sipas aktakuzës, dhe se janë përmbushur kushtet nga neni 248 i KPPK, për pranimin e fajësisë.

Gjykata me rastin e caktimit të llojit të dënimit dhe lartësisë së tij, mori për bazë të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, ashtu që si rrethana lehtësuese mori: se i akuzuari ka pranuar fajësinë për veprën penale, rrethanat e kryerjes së veprës penale, sjelljen e më hershme të të akuzuarit, sinqeritetin e treguar gjatë seancës, kushtet në të cilat jetoni akuzuar, gjendjen ekonomike të tij të renduar, intensitetin e rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur, nuk ka pasur pasoja nga vepra penale, andaj gjykata i shqiptoi dënimin të

akuzuarit si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindje se i njëjti i përgjigjet shkallës së përgjegjesisë penale të të akuzuarit, se me të do të ndikohet që të parandalohet i njëjti që të kryej ndonjë veprë penale në të ardhmen, se do t'i parandalojë personat e tjerë në kryerjen e veprës penale, se me të mjaftueshëm do të shprehet gjykim shoqëror për veprën penale, se do të ndikohet në ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, me çka në tërësi do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 41 dhe 50 të KPRK-së.

Vendim mbi konfiskimin e armës se lartceku, u mor në bazë të nenit 374 par.3 të KPRK-së.

Mbi shpenzimet e procedurës penale është vendosur konform nenit 450 par.1 dhe par.2 pika 2.1 lidhur me pikën 2.6 të KPPK-së.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 248 e365 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Aktgjykimi është përpiluar me datë 29.06.2020.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA

PKR.nr.102/2020 dt.29.06.2020

**Procesmbajtësja
Kimete Mehmeti**

**Kryetari i trupit gjykues,
Isuf Makolli**

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës Apelit të Kosovës me seli në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.